



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
DREJTORIA E ANALIZËS DHE METODOLOGJISË SË TREGJEVE

NJOFTIM

Rasti: Përftimi i kontrollit të shoqërisë Evag Emders Verkehrs Und Automotive mbH dhe Elag Emders Lagerhaus Und Automotive GmbH nga shoqëria Volkswagen Group Services GmbH.

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është protokolluar shkresa nr.609 prot.i AK, datë 12.10.2022, “Njoftim Përqendrimi”, me të cilën jemi njoftuar në lidhje me transaksionin e përfitimit të kontrollit të vetëm mbi shoqërinë Evag Emders Verkehrs Und Automotive mbH dhe Elag Emders Lagerhaus Und Automotive GmbH nga shoqëria Volkswagen Group Services GmbH.

Referuar marrëveshjes, palët janë:

Pala blerëse: Volkswagen Group Services GmbH është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit gjerman, me objekt aktiviteti: Ofrimi i shërbimeve dhe shërbimeve të kontratave të punës, veçanërisht të natyrës teknike dhe tregtare, kryesisht për shoqëritë e Grupit Volkswagen. Volkswagen Group Services GmbH është një filial i Grupit Volkswagen.

Volkswagen AG operon në Shqipëri përmes shoqërive të zotëruar indirekt prej tij, Porsche Albania SHPK dhe Porsche Leasing SHPK.

Pala shitëse: Schenker Aktiengesellschaft është një shoqëri aksionare me objekt aktiviteti: Dërgim kombëtar dhe ndërkombëtar nga toka, deti, ajri, përfundimi dhe zbatimi i transaksioneve të mallrave, ofrimi i shërbimeve të tjera logjistike, etj.

EVAG Emders Verkehrs und Automotive Gesellschaft mbH është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit gjerman, me objekt aktiviteti: Zhvillimi, organizimi dhe realizimi i transaksioneve kombëtare dhe ndërkombëtare të mallrave, magazinimi i të gjitha llojeve si dhe planifikimi, organizimi dhe zbatimi i koncepteve të tjera logjistike në fushën e prokurimit, shpërndarjes, prodhimit dhe logjistikës së transportit duke përfshirë shërbimet e konsulencës si dhe agjencinë dhe aktivitetet e ndërmjetësimit etj. Shoqëria Evag Emders Verkehrs Und Automotive mbH, është pronari i vetëm i të gjitha aksioneve tek shoqëria Elag Emders Lagerhaus und Automotive GmbH.

ELAG Emders Lagerhaus und Automotive GmbH është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit gjerman, me objekt aktiviteti: Zhvillimi, organizimi dhe realizimi i transaksioneve kombëtare dhe ndërkombëtare të mallrave, magazinimi i të gjitha llojeve si dhe planifikimi, organizimi dhe zbatimi i koncepteve të tjera logjistike në fushën e prokurimit,

shpërndarjes, prodhimit dhe logjistikës së transportit duke përfshirë shërbimet e konsulencës si dhe agjencinë dhe aktivitetet e ndërmjetësimit; riparimi dhe mirëmbajtja e mjeteve motorike dhe gjithë transaksionet e lidhura drejtpërdrejtë dhe indirekt për aktivitetet e përmendura.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Për sa më sipër, ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara, që brenda pesë ditëve nga shpallja e njoftimit, të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al.